



Kolegji AAB

Programi: Politikat sociale dhe mirëqenia e fëmijëve

Studimet Master

Punim masteri

**GJENDJA E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË
ASPEKTIN SOCIAL DHE NDIKIMI I POLITIKAVE
SOCIALE**

Mentori:

Prof. As. Dr. Shefqet Mulliqi

Kandidati:

Dafina Gashi Racaj

Prishtinë, 2018

Abstrakti

Qëllimi i këtij punimi është që të hulumtohet gjendja e fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovë. Duke analizuar dhe kuptuar gjendjen sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta, kam shqyrtuar dhe sugjeruar metoda për përmirësimin e gjendjes së tyre. Poashtu kam analizuar gjendjen e arsimit për fëmijët me nevoja të veçanta, me qëllim të vlerësimit të kushteve në arsim për këta fëmijë.

Në këtë punim do të bëhet një hulumtim për politikat sociale ndërkombëtare dhe ato vendore, për të drejtat e fëmijëve me nevoja të veçanta si dhe aspektin real të gjendjes aktuale të fëmijëve me nevoja të veçanta. Nga hulumtimi do të arrij në përcaktimin e gjendjes aktuale të fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovë, duke përfshirë çdo aspekt: social, ekonomik, arsimor, shoqëror etj. Fëmijët me nevoja të veçanta janë një kategori që kanë nevojë për studim të hollësishëm dhe një hulumtim statistikor për gjendjen e tyre në Kosovë. Rëndësia e kësaj teme qëndron në informimin real të kushteve, ligjeve dhe përfshirjes sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta. Përmes kësaj teme kam qëllim të paraqes gjendjen reale të kësaj kategorie dhe të specifikoj të metat që do të has në trajtimin shoqëror e social të fëmijëve me nevoja të veçanta. Poashtu do të hulumtohet procesi i gjithëpërfshirjes në arsim, si një sfidë tjetër për fëmijët me nevoja të veçanta. Do të shqyrtohen hapat e ndërmarrë nga ministria e arsimit si dhe organizatat e ndryshme botërore, që veprojnë në vend, për zhvillimin sa më cilësor të këtij procesi.

Përmes pyetësorëve të përgatitur do të arrijmë në përfundim për gjendjen në arsim të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe trajtimin e tyre nga shoqëria.

Fjalët kyçe: fëmijët me nevoja të veçanta, politikat sociale, korniza ligjore, fëmijët e verbër, fëmijët me sindromen Down.

Abstract

The aim of this master's thesis project is to investigate the situation of children with special needs in Kosovo. By analyzing and understanding the social situation of children with special needs, I have examined and suggested methods for improving their situation I have also analyzed the state of education for children with special needs, in order to evaluate the conditions of education for these children.

Through this master's thesis it will be investigated a research on international and local social policies on the rights of children with special needs and the real aspect of the current situation of children with special needs in Kosovo. The research will reach the definition of the current situation of children with special needs in Kosovo, including every social, economic, and educational aspect etc.

Children with special needs are a category that needs detailed study and statistical research on their situation in Kosovo. The importance of this topic lies in realizing the conditions, laws and social inclusion of children with special needs. Through this topic I intend to present the real situation of this category and to specify the flaws and social treatment of children with special needs in our society. The process of inclusion in education will also be explored as another challenge for children with special needs.

The steps taken by the Ministry of Education and various international organizations operating in the country will be considered for the qualitative development of this process.

Through the prepared questionnaires, it will be concluded the situation in the education of children with special needs and their treatment by the society.

Key words: children with special needs, social policies, the legal framework, blind children, children with Down syndrome.

5.2. Konkluzion

Përgjegjës për identifikimin e fëmijëve me nevoja të veçanta janë prindërit, edukatorët dhe mësuesit, ndërsa ligjërisht përgjegjëse janë institucionet shtetërore. Gjatë punës me fëmijë, mund të vërehen aftësitë e kufizuara gjatë procesit të rritjes, që nga lindja. Pasi që, shumë prindër, për shkak të paragjytimeve, hezitojnë t'i dërgojnë fëmijët e tyre me nevoja të veçanta në

shkollë, institucionet shtetërore janë përgjegjëse për të identifikuar dhe monitoruar këta fëmijë. Një gjë e tillë mund të arrihet përmes bashkëpunimit në mes të institucioneve arsimore dhe atyre shëndetësore e të mirëqenies sociale. Shpesh terminologjia e përdorur për këta fëmijë nuk është e qëlluar, pavarësisht se kohëve të fundit ka ndryshime. Kemi dëgjuar shpesh termat “fëmijë të hendikepuar, me të meta, jonormalë apo të deformuar, mirëpo këta terma nuk janë të përshtatshëm. Këta fëmijë nuk kanë asgjë tjetër veç se nevoja të veçanta, e këto specifikohen si pengesa në të folur, në të pamur, në të dëgjuar apo ngecje në zhvillimin mendor. Ata nuk janë me të meta, por thjeshtë kanë nevojë për kujdes të veçantë. Për të arritur këtë, duhet identifikuar me kohë nevojat e tyre të veçanta, në mënyrë që ta marrin me kohë kujdesin e duhur dhe të arrijnë qëllimet në jetë si të gjithë të tjerët.

Sipas hulumtimit të zhvilluar nëpër institucione të fëmijëve me nevoja të veçanta, kam arritur në përfundim se në Kosovë duhet punuar shumë që këta fëmijë të mund të arrijnë qëllimet e tyre. Në këto qëllime përfshihen edukimi dhe arsimimi, përfshirja në jetën sociale, kulturore e shoqërore. Në bazë të hulumtimit, sipas përgjigjeve të fëmijëve dhe përgjegjësve të shoqatave, kushtet në të cilat këta fëmijë edukohen dhe arsimohen, janë të vështira. Poashtu këta fëmijë, ndihen të diskriminuar nga shoqëria kosovare për shkak të nevojave të tyre të veçanta. Sipas këtyre rezultateve, është e nevojshme që të bëhen më shumë fushata sensibilizuese që këta fëmijë të mos ndihen ndryshe nga të tjerët.

Në Kosovë, ka shumë fëmijë me nevoja të veçanta, të cilët arsimohen në shkolla të rregullta dhe nuk marrin përkujdesje profesionale. Mungesa e asistentëve profesional nëpër shkolla të rregullta, fëmijëve me nevoja të veçanta u krijon probleme në arritjen e rezultateve pozitive në proceset mësimore. Mungesa e përkrahjes nga shteti, po i lë këta fëmijë pa asistencë profesionale. Ligji parasheh mundësi të barabarta për të gjithë fëmijët nëpër shkolla, por një gjë e tillë nuk po arrihet për shkak të mos ndarjes së buxhetit të mjaftueshëm për staf profesional për fëmijët me nevoja të veçanta.

Nisur nga ky problem, Ministria e Arsimit ka vendosur që 100 asistentë të shpërndahen për gjitha shkollat e Kosovës. Ata, pritet që të fillojnë me këtë punë nga janari të vitit 2019. Por, ky numër i asistentëve, sipas organizatave që merren me të drejtat e fëmijëve dhe prindërve, është fare i vogël dhe i pamjaftueshëm për t'i mbuluar nevojat. (Insajderi, 2018)

Sipas hulumtimit, nuk ka mekanizma të mjaftueshëm që sigurojnë përfshirjen e mjaftueshme të fëmijëve me nevoja të veçanta në aktivitete kulturore e shoqërore. Këta fëmijë kanë nevojë për përkujdesje të veçantë, por janë fëmijë të talentuar, prandaj edhe duhet krijuar mundësitë që të shprehin talentin e tyre. Prandaj, ky hulumtim, ka rëndësi të madhe që përmes tij të kuptohet gjendja e fëmijëve me nevoja të veçanta, kushtet në të cilat ata edukohen dhe arsimohen dhe mënyra se si ndihen ata në një shoqëri ku akoma ka diskriminime.

Sipas analizës së pyetësorëve të realizuar në tri institucione që kujdesen për fëmijë me nevoja të veçanta, kam ardhur në përfundim se këta fëmijë nuk kanë as kushtet dhe as përkrahjen e duhur për të jetuar barabartë me fëmijët tjerë.

Sa i përket hipotezë “Fëmijët me nevoja të veçanta kanë vështirësi në proceset arsimore për shkak të mungesës së qasjes në informacione”, rezultatet kanë gjeneruar të dhëna se në proceset arsimore, fëmijët me nevoja të veçanta, kanë vështirësi. Sipas pyetësorit të parë, 17 respondentë kanë dhënë përgjigje se fëmijët me nevoja të veçanta “pak” arrijnë të edukohen dhe arsimohen në Kosovë; në pyetësorin e dytë, shumica prej tyre do të thotë 16 nga ata, kanë dhënë përgjigje se “pak” arrijnë të edukohen dhe arsimohen në Kosovë fëmijët me nevoja të veçanta; edhe fëmijët me probleme në të parë, 11 prej tyre, kanë dhënë përgjigje se nuk janë pak të kënaqur me arritjet në mësim. Ndërsa në pyetësorin për prindërit e fëmijëve me probleme në të parë, pyetjen për mundësitë e integritit në shoqëri të fëmijëve me probleme në të parë, shumica prej tyre kanë, do të thotë 15 nga ata, kanë dhënë përgjigjen “pak”. Nga të gjitha përgjigjet, arrihet deri te përfundimi se, në Kosovë, fëmijët me nevoja të veçanta, hasin në vështirësi në proceset arsimore dhe nuk janë të kënaqur me të arriturat e tyre në mësim.

Fëmijët me nevoja të veçanta janë pak të përfshirë në arsim për shkak të kushteve të papërshtatshme në institucionet arsimore. Sa i përket hipotezës së dytë, nga rezultatet e gjeneruara në të katër pyetësorët, del se procesi i gjithpërfshirjes ka mangësi. Sipas hulumtimit, politikat sociale kanë shumë pak ndikim në procesin e gjithpërfshirjes në institucionet arsimore, poashtu kushtet e papërshtatshme limitojnë këtë proces për fëmijët me nevoja të veçanta.

Ka mungesë të stafit të profesionalizuar për fëmijët me nevoja të veçanta, ju mungon kujdesi i duhur profesional. Edhe sipas hipotezës së tretë, hulumtimi ka gjeneruar të dhëna nga përfaqësuesit e shoqatës “Down Syndrome Kosova” për mungesë stafi të specializur për fëmijët

me nevoja të veçanta, ku 15 prej respondentëve kanë dhënë përgjigje se nuk ka staf të specializuar, poashtu edhe në shoqatën “Handikos”, shumica prej tyre (13 të intervistuar) kanë dhënë përgjigje se nuk ka staf të specializuar për fëmijët me nevoja të veçanta. Ndërkaq, prindërit e fëmijëve me probleme në të parë, shumica prej tyre gjegjësisht 16 prej tyre, janë përgjigjur “po” ka staf të specializuar për fëmijët me probleme në tëparë. Mirëpo, vlen të theksohet se përgjigjet e prindërve kanë të bëjnë vetëm me fëmijët e vendosur në Qendren Burimore për Mësim dhe Këshillim “Xheladin Deda”, ku ka staf të specializuar për fëmijët e verbër. Stafi i specializuar mungon në shkollat e rregullta. Prandaj, arrihet te përfundimi se, në Kosovë, ka mungesë të stafit të specializuar për fëmijët me nevoja të veçanta.

Fëmijët me nevoja të veçanta janë shumë pak të përfshirë në jetën sociale. Sa i përket hipotezës së katërt, përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në jetën sociale mbetet sfidë. Në shoqatën “Down Syndrome Kosova”, të respondentët kanë dhënë përgjigjen “pak” për përfshirjen e fëmijëve me sindromën Doën në jetën sociale. Sipas analizës kjo ndodh për shkak të mungesës së aktiviteteve shoqërore e kulturore, pasi që 17 prej tyre kanë dhënë përgjigjen “pak” për përfshirjen në jetën shoqërore e kulturore të fëmijëve me sindromën Down. Edhe të dhënat në shoqatën “Handikos”, rezultojnë me shumicën e përgjigjeve “pak” *(18) për përfshirjen në jetën sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Sa i përket pyetjes kërkimore 1 “A janë të përfshirë në jetën sociale, fëmijët me nevoja të veçanta”, të dhënat kanë treguar se, fëmijët me nevoja të veçanta, nuk janë të përfshirë në jetën sociale, kjo tregon se ka nevojë për mekanizma që inkurajojnë përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në jetën sociale. Sipas pyetësorit të parë, të gjithë respondentët (20) kanë dhënë përgjigje “pak” për përfshirjen e fëmijëve me sindromën Down në jetën sociale; poashtu në “Handikos”, shumica prej të intervistuarve, 18 prej tyre, kanë dhënë përgjigjen “pak” për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në jetën sociale.

Sa i përket pyetjes kërkimore 2 “A ka staf profesional për fëmijët me nevoja të veçanta, në institucionet arsimore”, hulumtimi ka gjeneruar të dhëna të ndryshme në mes të fëmijëve tëverbër dhe atyre me sindromën Down. Sipas rezultateve, për fëmijët e verbër ka staf të specializuar, në bazë të përgjigjeve të prindërve, shumica prej tyre (16) kanë dhënë përgjigjen se ka staf të specializuar, në “Handikos” shumica mendojnë se nuk ka staf profesional, poashtu edhe në shoqatën “Down Syndrome Kosova”, 15 respondentë kanë dhënë përgjigjen se nuk ka

staf profesional. Duke u nisur nga këto përgjigje dhe nga hulumtimi në teren, si përfundim në Kosovë nuk ka staf profesional për fëmijët me nevoja të veçanta, pasi që në institucionet arsimore, në shkollat (klasat) e rregullta, mungojnë asistentët mbështetës të specializuar për nevojat e veçanta të fëmijëve.

Sa i përket kërkimore 3 “A ka infrastrukturë të përshtatshme në institucionet shkollore për fëmijët me nevoja të veçanta”, ka mospërputhje në mes të të dhënave, prindërit e fëmijëve me të verbër mendojnë se ka infrastrukturë të përshtatshme për levizje poashtu edhe fëmijët, ndërsa përfaqësuesit e shoqatës “Handikos” mendojnë se nuk ka infrastrukturë të mjaftueshme për fëmijët me nevoja të veçanta. Nga hulumtimi është arritur përfundimi se stafi i specializuar mungon në shkollat e rregullta, sepse jo të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta mund të ndjekin mësimet në shkollat speciale.

Sipas pyetjes kërkimore 4 “A i gëzojnë të drejtat e tyre fëmijët me nevoja të veçanta”, të dhënat tregojnë se, në Kosovë, fëmijët me nevoja të veçanta, i gëzojnë pak të drejtat e tyre. Ky përfundim është nxjerrë nga përgjigjet e dhëna në pyetësorët: në shoqatën “Down Syndrome Kosova” ku 14 prej të intervistuarve kanë dhënë përgjigjen “pak”, në shoqatën “Handikos” shumica prej respondentëve, 18 prej tyre kanë dhënë përgjigjen “pak” për respektimin e të drejtave të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Sipas pyetjes kërkimore 5 “A ka shërbime të rehabilitimit (mjaftueshëm) për fëmijët me nevoja të veçanta”, të dhënat, në shoqatën “Down Syndrome Kosova” dhe në “Handikos”, tregojnë se në Kosovë ka shërbime të rehabilitimit për fëmijët me nevoja të veçanta, që ofrohen nga shoqatat “Doën Syndrome Kosova” dhe “Handikos”, duke ofruar lojëra, mësimet dhe aktivitete argëtuese për fëmijët me nevoja të veçanta. Ndërsa shoqata “Handikos”, organizon edhe vizita në teren për fëmijët që nuk kanë mundësi të shkojnë në objektin e shoqatës.

Pyetja kërkimore 6 “Sa ka nevojë për ndryshim të politikave sociale për fëmijët me nevoja të veçanta”, na jep të dhëna se në Kosovë ka nevojë të bëhen ndryshime të politikave sociale për përfshirjen e fëmijëve në jetën sociale si dhe për procesin e gjithëpërfshirjes. Sipas rezultateve të hulumtimit, 18 prindër të fëmijëve më dëmtime në të parë kanë dhënë përgjigjen “shumë” për nevojën e ndryshimit të politikave sociale. Në shoqatën “Handikos”, nga 20 të intervistuar, 18 prej tyre kanë dhënë përgjigjen “po” për ndryshimin e politikave sociale, ndërsa në shoqatën

“Doën Syndrome Kosova”, të gjithë të intervistuarit (20) kanë dhënë përgjigjen “po” se a duhet të ndryshohen politikat sociale. Sipas hulumtimit është arritur përfundimi se, në Kosovë, ka nevojë për ndryshimin e politikave sociale për fëmijët me nevoja të veçanta. Vështirësitë që fëmijët hasin në procesin e edukimit dhe arsimit linden nevojën për krijimin e politikave më të forta sociale që të kenë ndikim në tërë vendin.

Edhe sipas pyetjes kërkimore 7 “Sa ka ndikim shteti në procesin e gjithëpërfshirjes në arsim”, ka të dhëna se shteti ka pak ndikim në procesin e gjithëpërfshirjes në arsim. Ky përfundim është nxjerrë nga rezultatet e pyetësorëve dhe hulumtimit në teren ku: në shoqatën “Down Syndrome Kosova” 13 të intervistuar kanë dhënë përgjigjen se politikat sociale kanë pak ndikim në procesin e gjithëpërfshirjes në arsim, në “Handikos” 15 të intervistuar që e përbëjnë shumicën e respondentëve, kanë dhënë poashtu përgjigjen “pak” si dhe prindërit e fëmijëve me probleme në të parë, shumica prej tyre (13) kanë dhënë përgjigjen se shteti ka pak ndikim në procesin e gjithëpërfshirjes në arsim për fëmijët me probleme në të parë.